



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 237

Tiranë – E mërkurë, 6 janar 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 108/2015, datë 21.12.2015	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 55/2014, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”, të ndryshuar..... 16243
Vendim i Kuvendit nr. 110/2015, datë 21.12.2015	Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore..... 16245
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave nr. 7, datë 14.12.2015	Për aromatizuesit dhe përbërës të caktuar ushqimorë me veti aromatizuese, të përdorur në prodhimin e produkteve ushqimore..... 16245
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 156, datë 24.12.2015	Mbi lënien në fuqi të vendimeve nr. 139, nr. 140, nr. 141, nr. 145, nr. 146, nr. 147, nr. 148, datë 26.12.2014, si dhe të vendimit nr. 27, datë 16.2.2015, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, për periudhën 1 janar 2016 – 30 qershor 2016..... 16254
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 157, datë 28.12.2015	Mbi miratimin e një ndryshimi në rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike..... 16255
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 158, datë 28.12.2015	Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Albanian General Electricity” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike..... 16255
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 159, datë 28.12.2015	Për licencimin e shoqërisë “Le Trading Albania” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike..... 16256
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 160, datë 28.12.2015	Për rinovimin e licencës së shoqërisë “GSA” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 57, datë 22.6.2011..... 16256

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 161, datë 28.12.2015	Për licencimin e shoqërisë “Nishova Energy” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Nishove”, me fuqi të instaluar 1360 kW.....	16257
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 162, datë 28.12.2015	Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Kisi – Bio - Energji” sh.p.k., për lënien peng të aseteve të saj si kolateral pranë “Raiffeisen Bank”.....	16258
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 163, datë 28.12.2015	Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “HEC Tervoli” sh.p.k., për lënien peng të aseteve të saj si kolateral pranë “Raiffeisen Bank”.....	16258
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 164, datë 28.12.2015	Për ndryshimin e vendimit nr. 143, datë 26.11.2015, të Bordit të ERE-s.	16259
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 165, datë 28.12.2015	Për ndryshimin e vendimit nr. 142, datë 26.11.2015, të Bordit të ERE-s.	16259
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 166, datë 28.12.2015	Mbi kërkesën e KESH sh.a. për miratimin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike midis shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë “HEC Lanabregas” sh.a.....	16260
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 6720, datë 23.12.2015	Për shpronësim publik, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit “Pikë panoramike dhe sportive, Llogara, Himarë”.....	16261

VENDIM
Nr. 108/2015

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E KUVENDIT NR. 55/2014 “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS,
ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË
POZICIONEVE TË PUNËS TË
INSPEKTORATIT TË LARTË TË
DEKLARIMIT E KONTROLLIT TË
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË
INTERESAVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:


I. Lidhja nr. 1 (struktura) e vendimit të Kuvendit nr. 55/2014, të ndryshuar, ndryshohet sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Lidhja nr. 2 (organika) e vendimit të Kuvendit nr. 55/2014, të ndryshuar, ndryshohet sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 21.12.2015





Lidhja nr. 2

**ORGANIKA DHE NUMRI I PUNONJËSVE TË INSPEKTORATIT TË LARTË
TË DEKLARIMIT E KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT
TË INTERESAVE**

Funksioni	Nr. i punonjësve /Kategoria/klasa	
I. Inspektori i Përgjithshëm	1	Ligj nr. 9584, datë 17.7.2006
II. Kabineti		
Drejtor Kabineti	1	II-a
Këshilltar	1	II-b
Sekretar i Inspektorit të Përgjithshëm	1	VKM
III. Sekretari i Përgjithshëm	1	I-b
IV. Inspektorë		
Inspektorë	15	II-a
Ndihmësinpektorë	12	II-b
V. Drejtoria e Kontrollit Paraprak, Aritmetik-Logjik dhe e Konfliktit të Interesave		
Drejtor	1	II-b
Specialistë	4	III-b
VI. Drejtoria Juridike dhe e Marrëdhënieve me Institucionet		
Drejtor	1	II-b
VI/1. Sektori i Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialistë	3	III-b
VI/2. Sektori i Këshillimit Juridik		
Specialistë	2	III-b
VII. Drejtoria e Financave dhe Administrimit		
Drejtor	1	II-b
VII/1. Sektori i Administrimit të IT-së		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialistë	2	III-b
VII/2. Sektori i Protokoll-Arkivit dhe Administrimit të Deklaratave të Pasurisë		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialistë	4	III-b
VII/3. Sektori i Administrimit të Financë-Buxhetit		
Specialist finance	1	IV-a
Specialist buxheti	1	III-b
Magaznier	1	VI
Shofer	1	IV
Receptionist	1	III
Pastruese	2	I
Gjithsej	60	punonjës



VENDIM
Nr. 110/2015

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË
POSAÇËM PARLAMENTAR
PËR REFORMËN ZGJEDHORE

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës, dhe nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore (në vazhdim Komisioni).

II. Komisioni ka për detyrë hartimin e amendamenteve për kuadrin ligjor zgjedhor, për trajtimin e rekomandimeve të raporteve të OSBE/ODHIR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2013 dhe ato vendore të vitit 2015.

III. Anëtarësia e Komisionit formohet me pjesëmarrjen e partive parlamentare, me përbërje të barabartë mes shumicës dhe pakicës, sipas përbërjes së caktuar në këtë vendim.

IV. Komisioni do të zhvillojë konsultime dhe seancë diskutimi me partitë politike joparlamentare, të interesuara për reformën zgjedhore, të cilat në zgjedhjet e fundit kanë më shumë se 1 për qind të votave në shkallë vendi, si dhe me përfaqësues të shoqërisë civile, që kanë ekspertizë dhe eksperiencë në procesin zgjedhor.

Konsultime dhe dëgjesa publike do të zhvillohen edhe me kërkesë të palëve dhe me përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe institucione shtetërore që luajnë një rol në procesin zgjedhor.

V. Komisioni drejtohet nga dy bashkëkryetarë, një nga Partia Socialiste dhe tjetri nga Partia Demokratike.

VI. Pranë Komisionit ngrihet grupi i ekspertëve teknikë. Përbërja dhe mënyrat e funksionimit përcaktohen me vendim të Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

VII. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, OSBE/ODIR-it, dhe Komisioni i Venecias ftohen të ndjekin dhe të japin asistencë dhe ekspertizë teknike në punimet e Komisionit dhe të grupit të ekspertëve të ngritur pranë tij.

VIII. Çdo parti parlamentare ka të drejtë të propozojë amendamente për diskutim dhe miratim. Shumica parlamentare mirëpret propozimet e pakicës parlamentare, të bazuar në rekomandimet e OSBE/ODIR-it dhe palët angazhohen të gjejnë konsensusin në lidhje me to. Për çështje të veçanta, për të cilat palët nuk kanë gjetur konsensus, konsensusi do të kërkohej në asistencën dhe ekspertizën e OSBE/ODIR-it dhe Komisionit të Venecias.

IX. Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Vendimmarrja e Komisionit do të synojë konsensusin e gjerë për të gjitha propozimet. Vendimet e Komisionit quhen të miratuara me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve dhe vetëm kur kanë marrë konsensusin e Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike.

X. Komisioni përbëhet nga 10 anëtarë (5 anëtarë nga shumica parlamentare dhe 5 anëtarë nga pakica parlamentare).

XI. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat tremujor nga data e mbledhjes së parë të tij. Në rast nevojë, me kërkesë të arsyetuar të bashkëkryetarëve, Kuvendi vendos zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së Komisionit.

XII. Ngarkohen Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së këtij Komisioni të Posaçëm dhe të grupit të ekspertëve të ngritur pranë tij.

XIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir META

Miraturar në datën 21.12.2015

UDHËZIM

Nr. 7, datë 14.12.2015

PËR AROMATIZUESIT DHE PËRBËRËS
TË CAKTUAR USHQIMORË ME VETI
AROMATIZUESE, TË PËRDORUR NË
PRODHIMIN E PRODUKTEVE
USHQIMORE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, dhe të nenit 41, pika 12, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar,



UDHËZOJ:

I. Dispozita të përgjithshme

1. Ky udhëzim, përcakton rregullat për aromatizuesit dhe përbërësit e caktuar ushqimorë me veti aromatizuese, të përdorur në produktet ushqimore, me qëllim që të sigurohet një funksionim efektiv i tregut të brendshëm, të sigurohet një nivel i lartë i mbrojtjes së shëndetit të njerëzve, interesave të konsumatorit dhe praktikave të drejta në tregtinë e produkteve ushqimore, duke marrë në konsideratë kur është e nevojshme, edhe mbrojtjen e mjedisit.

2. Ky udhëzim, zbatohet për:

a) aromatizuesit, të cilët përdoren ose janë të destinuar për t'u përdorur në produktet ushqimore, pa cenuar dispozitat më specifike të përcaktuara në urdhrin nr. 1, datë 26.1.2009, "Për aromatizuesit tymues të përdorur ose përcaktuar të përdoren në ushqime";

b) përbërësit e caktuar ushqimorë me veti aromatizuese;

c) produktet ushqimore që përmbajnë aromatizues dhe/ose përbërësit ushqimorë me veti aromatizuese;

d) materialet burimore për aromatizuesit dhe/ose materialet burimore për përbërësit e ushqimit me veti aromatizuese.

Ky udhëzim, nuk zbatohet për:

a) substancat, të cilat kanë vetëm shije të ëmbël, të thartë ose të kripur;

b) ushqimet e papërpunuara;

c) ushqimet jo të përbëra dhe përzierje të tilla, por jo vetëm, erëza dhe/ose bimë aromatizuese të freskëta, të thata ose të ngrira, përzierjet e çajit dhe përzierjet për ekstraktim, për aq kohë sa ato nuk përdoren si përbërës ushqimor.

3. Për qëllim të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "Aromatizues" nënkupton produktin:

i) që nuk është përcaktuar për t'u konsumuar si i tillë, i cili është shtuar në ushqim, me qëllim që t'i japë ose modifikojë aromën dhe/ose shijen;

ii) i bërë apo i përbërë nga kategoritë e mëposhtme: substancat aromatizuese, përgatitjet aromatizuese, aromatizues i përfutur nga një proces termik, duhan aromatizues, aromatizuespararendës apo aromatizues të tjerë ose përzierjet e tyre.

b) "Substancë aromatizuese", nënkupton një substancë kimike të caktuar me veti aromatizuese.

c) "Substancë aromatizuese natyrore", nënkupton një substancë aromatizuese të përfutur nga procese të përshtatshme fizike, enzimatike apo mikrobiologjike nga materiale me origjinë bimore, shtazore ose mikrobiologjike, ose në gjendjen para ose pas përpunimit për konsum njerëzor nga një ose më shumë procese të përgatitjes së ushqimit tradicional, të listuara në shtojcën I. Substancat aromatizues natyrore korrespondojnë me substancat që janë natyrisht të pranishme dhe janë identifikuar në natyrë.

ç) "Përgatitje aromatizuese", nënkupton një produkt tjetër nga substanca aromatizuese, e përfutur nga:

i) ushqimi nga procese të përshtatshme fizike, enzimatike apo mikrobiologjike, në gjendjen para ose pas përpunimit të materialit për konsum njerëzor nga një ose më shumë procese tradicionale të përgatitjes së ushqimeve të listuara në shtojcën I të këtij udhëzimi; dhe/ose

ii) materiale me origjinë bimore, shtazore ose mikrobiologjike, të tjera nga ushqimet, të marra nga procese të përshtatshme fizike, enzimatike ose mikrobiologjike, si të tilla ose të përgatitura nga një ose më shumë procese tradicionale të përgatitjes së ushqimeve të listuara në shtojcën I;

d) "Aromatizues i përfutur nga një proces termik", nënkupton një produkt të përfutur pas trajtimit në të nxehtë të një përzierje të përbërësve jo detyrimsht me veti aromatizuese, nga të cilët të paktën njëri përmban azot (*amino*) dhe tjetri është një sheqer reduktues. Përbërësit për prodhimin e aromatizuesit nga një proces termik mund të jenë:

i) ushqim; dhe/ose

ii) materiale burimore të tjera nga ushqimi.

dh) "Aromatizues tymues", nënkupton një produkt të përfutur nga fraksionimi dhe pastrimi i një tymi të kondensuar, i prodhuar nga kondensati i tymit primar, fraksionet primare të katranit dhe/ose aromatizues tymues të derivuar siç përcaktohet në pikën 2, germat "a", "b" dhe "d", të urdhrin nr. 1, datë 26.1.2009, "Për aromatizuesit tymues të përdorur ose përcaktuar të përdoren në ushqime".

e) "Aromatizues pararendës", nënkupton një produkt, jo domosdoshmërisht me veti aromatizuese, e shtuar qëllimisht në ushqim me qëllimin e vetëm të prodhimit të aromës duke vepruar ose ndërprerëveprimin me komponentët



e tjerë gjatë përpunimit të ushqimit. Ai mund të përftohet nga:

i) ushqimi; dhe/ose

ii) materiale burimore të tjera nga ushqimi.

f) “aromatizues tjetër”, nënkupton një aromatizues të shtuar ose të përcaktuar për t'u shtuar në ushqim, në mënyrë që të japë aromë dhe/ose shije dhe që nuk përfshihet në përkufizimet e dhëna në germa “b” deri “e” të kësaj pike.

i) “Përbërës i ushqimit me veti aromatizuese”, nënkupton një përbërës ushqimor, tjetër nga aromatizuesit, që mund të shtohet në ushqim për qëllimin kryesor të shtimit ose modifikimit të aromës dhe që kontribuon në mënyrë të konsiderueshme për praninë në ushqim të disa substancave të padëshiruara.

g) “Material burimor”, nënkupton materialet me origjinë bimore, shtazore, mikrobiologjike ose minerale nga të cilat aromatizuesit ose përbërësit ushqimor me veti aromatizuese janë prodhuar. Ai mund të jetë:

i) ushqim; ose

ii) material burim tjetër nga ushqimi.

gj) “Proces fizik i përshtatshëm”, nënkupton një proces fizik, i cili nuk modifikon qëllimisht natyrën kimike të përbërësve të aromatizuesve, pa paragjykuar këtu listën e proceseve tradicionale të përgatitjes së ushqimit dhënë në shtojcën I, dhe nuk përfshin, ndër të tjera, përdorimin e vetëm të oksigjenit, ozonit, katalizatorëve inorganikë, katalizatorëve metalikë, reagentëve organometalikë dhe/ose rrezatimit UV.

4. Në përputhje me përkufizimet e dhëna në pikën 3, shkronjat “ç”, “d”, “e” dhe “f”, materialet burimore, për të cilat nuk ka të dhëna të rëndësishme të përdorimit për prodhimin e aromatizuesve, do të konsiderohen si ushqim për qëllim të këtij udhëzimi.

5. Aromatizuesit mund të përmbajnë aditivë ushqimorë ashtu si parashikohet në udhëzimin nr. 18, datë 17.11.2010, “Për aditivët ushqimorë”, dhe/ose përbërës të tjerë ushqimorë të përfshira për qëllime teknologjike.

II. Kushtet për përdorimin e aromatizuesve, përbërësve ushqimorë me veti aromatizuese dhe materialeve burimore

1. Vetëm aromatizuesit ose përbërësit ushqimorë me veti aromatizuese, të cilët i

plotësojnë kushtet e mëposhtme, mund të përdoren në ushqime:

a) nuk përbëjnë rrezik për shëndetin e konsumatorit, bazuar në të dhënat shkencore në dispozicion;

b) përdorimi i tyre nuk çorienton konsumatorin.

2. Operatori i biznesit ushqimor nuk mund të vendosë në treg një aromatizues apo ndonjë ushqim në të cilin një aromatizues dhe/ose përbërës ushqimorë me veti aromatizuese është i pranishëm, nëse përdorimi i tyre nuk është në përputhje me këtë udhëzim.

3. Substancat e listuara në pjesën A të shtojcës II të këtij udhëzimi, nuk do të shtohen si të tilla në ushqim.

4. Përveç sa përcaktohet në urdhrin nr. 223, datë 8.7.2009, “Për miratimin e rregullores “Mbi rregullat e përgjithshme, për përcaktimin, përshkrimin dhe prezantimin e pijeve alkoolike””, nivelet maksimale të substancave të caktuara, natyralisht të pranishme në aromatizues dhe/ose përbërësit ushqimorë me veti aromatizuese, në produktet ushqimore të përbëra të listuara në pjesën B, të shtojcës II, nuk do të tejkalohen si rezultat i përdorimit të aromatizuesve dhe/ose përbërësve ushqimorë me veti aromatizuese në ato produkte ushqimore. Nivelet maksimale të substancave të përcaktuara në shtojcën II, do të zbatohen për produktet ushqimore në gjendjen përfundimtare, ashtu siç tregtohen, nëse nuk shprehet ndryshe. Duke zbatuar këtë parim, për ushqime të thata dhe/ose të koncentruara, të cilat duhet të riformohen, nivelet maksimale do të zbatohen për ushqimin e riformuar sipas udhëzimeve në etiketë, duke marrë parasysh faktorin minimal të hollimit.

5. Materialet burimore të dhëna në pjesën A, të shtojcës III, të këtij udhëzimi, nuk do të përdoren për prodhimin e aromatizuesve dhe/ose përbërësve ushqimorë me veti aromatizuese.

6. Aromatizuesit dhe/ose përbërësit ushqimorë me veti aromatizuese, të prodhuara nga materialet burimore, të listuara në pjesën B të shtojcës III, mund të përdoren vetëm në kushtet e përcaktuara në këtë shtojcë.

7. Aromatizuesit e mëposhtëm dhe përbërësit ushqimorë me veti aromatizuese mund të përdoren në ushqime, me kusht që ato janë në



përputhje me përcaktimet në pikën 1, të këtij kreu:

a) përgatitjet aromatizuese të përcaktuara në shkronjën “ç”/i, të pikës 3, të kreut I;

b) aromatizuesit e përftuar nga procese termike të përcaktuara në shkronjën “d”/i, të pikës 3, të kreut I, të cilat plotësojnë kushtet për prodhimin e aromatizuesve me procese termike dhe nivelet maksimale për substanca të caktuara në aromatizuesit e përftuar nga procese termike përcaktuar në shtojcën IV të këtij udhëzimi;

c) aromatizuesit pararendës të përcaktuar në shkronjën “e”/i, të pikës 3, të kreut I;

d) përbërësit ushqimorë me veti aromatizuese.

8. Pavarësisht përcaktimit në pikën 7 të këtij kreu, nëse ka dyshime në lidhje me sigurinë e një aromatizuesi apo përbërësi ushqimor me veti aromatizuese, të përcaktuar në pikën 7, Komiteti Shkencor dhe panelet shkencore të kryejnë një vlerësim rreziku për to.

III. Aromatizuesit dhe materialet burimore të miratuara për përdorim në produktet ushqimore

1. Aromatizuesit dhe materialet burimore të miratuara për përdorim në produktet ushqimore, janë si më poshtë:

a) substancat aromatizuese;

b) përgatitjet aromatizuese të përcaktuar në shkronjën “ç”/ii, të pikës 3, të kreut I;

c) aromatizuesit e përftuar nga procese termike të marra nga përbërësit e trajtuar termikisht, të cilat janë tërësisht apo pjesërisht në përputhje me shkronjën “d”/ii, të pikës 3, të kreut I dhe/ose për të cilat kushtet për prodhimin e aromatizuesve të përftuar nga procese termike dhe/ose nivelet maksimale për substanca të caktuara të padëshirueshme të përcaktuara në shtojcën IV nuk janë plotësuar;

d) aromatizuesit pararendës, të përcaktuar në shkronjën “e”/ii, të pikës 3, të kreut I;

e) aromatizues të tjerë nga ata të përcaktuar shkronjën “P”, të pikës 3, të kreut I;

f) materiale burimore të tjera nga ato të përcaktuara në shkronjën “g”/ii, të pikës 3, të kreut I.

IV. Etiketimi

A. Etiketimi i aromatizuesve të cilët nuk janë të destinuar për t’u shitur te konsumatori i fundit

1. Aromatizuesit, të cilët nuk janë të destinuar për t’u shitur te konsumatori i fundit mund të tregtohet vetëm të etiketuar në përputhje me

përcaktimet e shkronjës A, pika 2, dhe shkronjës B të këtij kreu. Etiketa duhet të jetë lehtësisht e dukshme, qartësisht e lexueshme dhe e pashlyeshme.

Informacioni i dhënë në pikën 2 të këtij kreu, duhet të jetë në gjuhë të kuptueshme për blerësit. Ai duhet të jetë në shqip dhe gjuhë të tjera.

2. Kur aromatizuesit, të cilët nuk janë të destinuar për t’u shitur te konsumatori përfundimtar, por janë shitur në formë individuale apo të përzier me njëri-tjetrin dhe/ose me përbërës të tjerë ushqimorë dhe/ose me substanca të tjera të shtuar në to, në përputhje me pikën 4, të kreut I, paketimi i tyre ose kontejnerët duhet të mbajnë informacionin e mëposhtëm:

a) përshkrimin e shitjes ose fjalën “aromatizues” ose një emër më specifik ose përshkrimin e aromatizuesit;

b) deklaratën ose “për ushqim”, ose “përdorim i kufizuar në ushqim”, ose një referencë shumë të veçantë për përcaktimin e tij për përdorim në ushqime;

c) nëse është e nevojshme, kushtet e veçanta për ruajtjen dhe/ose përdorim;

d) një shenjë identifikuese për grumbullin ose lot-in;

e) në rend zbritës të peshës, një listë me:

i) kategoritë e aromatizuesve të pranishëm;

ii) emrat e secilit prej substancave ose materialeve të tjera në produkt ose, kur është e përshtatshme, numrin E, të tyre.

f) emrin ose emrin e biznesit dhe adresa e prodhuesit, paketuesit ose shitësit;

g) një tregues të sasisë maksimale për secilin komponent ose grup komponentësh që i nënshtrohen kufizimit sasior në ushqime dhe/ose informacionin e duhur në terma të qartë dhe lehtësisht të kuptueshëm për blerësin;

h) sasinë neto;

i) datën e qëndrueshmërisë minimale ose “*use by date*”;

j) aty ku është e mundur, informacioni mbi një aromatizues ose substanca të tjera të përmendura në këtë pikë dhe të listuara në shtojcën III, të vendimit nr. 1344, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për etiketimin e produkteve ushqimore”.



3. Pavarësisht përcaktimit në pikën 1 të këtij kreu, të dhënat e nevojshme në shkronjat “d” dhe “e” të pikës 2, mund të vendosen vetëm në dokumentet që kanë të bëjnë me ngarkesat të cilat janë për t’u furnizuar në kohën e dorëzimit ose para tij, me kusht që treguesi “jo për shitje me pakicë” të jetë i vendosur në një pjesë lehtësisht të dukshme të paketimit ose të kontejnerit të produktit në fjalë.

4. Pavarësisht përcaktimit në pikën 1 të këtij kreu, kur aromatizuesit janë furnizuar në depozita, të gjitha informacionet mund të vendosen në dokumentet shoqëruese që shoqërojnë ngarkesën.

B. Kërkesat specifike për përdorimin e termi “natyral”

1. Termi “natyral” do të përdoret për të përshkruar një aromatizues në përshkrimin e shitjes së tij sipas pikës 1/a, të shkronjës A, të këtij kreu.

2. Termi “natyral”, për përshkrimin e një aromatizuesi, mund të përdoret vetëm nëse përbërësi aromatizues përbëhet vetëm nga përgatitje aromatizuese dhe/ose substanca aromatizuese natyrale.

3. Termi “substancë aromatizuese natyrale” mund të përdoret vetëm për ata aromatizues në të cilin përbërësi aromatizues përmban substanca aromatizuese ekskluzivisht natyrore.

4. Termi “natyral” mund të përdoret në kombinim me një referencë për një ushqim, kategori ushqimesh ose burim aromatizuesi me origjinë bimore ose shtazore, në qoftë se përbërësi aromatizues është fituar ekskluzivisht ose të paktën 95% të peshës/peshë, nga burimi i materialeve të cituara më lart. Përshkrimi do të lexohet “aromatizues natyral”, “ushqimi ose kategoria e ushqimit ose burimi”.

5. Termi “aromatizues natyral”, “ushqim ose kategori ushqimi ose burimi”, me aromatizues natyral të tjerë”, mund të përdoret vetëm nëse përbërësi aromatizues është fituar pjesërisht nga materiali burimor i përmendur, aromë e cila mund të njihet lehtësisht.

6. Termi “aromatizues natyral” mund të përdoret vetëm nëse përbërësi aromatizues rrjedh nga materiale të ndryshme burimore dhe ku një referencë e materialeve të burimit nuk do të reflektojë aromën apo shijen e tyre.

C. Etiketimi i aromatizuesve të destinuar për t’u shitur te konsumatori i fundi

1. Përveç sa parashikohet në vendimin nr. 1344, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për etiketimin e produkteve ushqimore”, mbi treguesit ose shenjat e identifikimit të *lot*-it, të cilit një ushqim i përket, aromatizuesit e shitur veçmas ose të përzierë me njëri-tjetrin dhe/ose me përbërës të tjerë të ushqimit dhe/ose substanca të tjera, të cilat janë shtuar dhe që janë të destinuara për shitje te konsumatori i fundit, mund të tregtohet vetëm nëse paketimi i tyre përmban deklaratën ose “për ushqim”, ose “përdorim i kufizuar në ushqim”, ose një referencë më specifike për përdorimin e tyre në ushqim. Kjo deklaratë, duhet të jetë lehtësisht e dukshme, në mënyrë të qartë e lexueshme dhe e pashlyeshme.

2. Në qoftë se termi “natyral” përdoret për të përshkruar një aromatizues në përshkrimin e shitjes referuar shkronjës A, pika 1/a, atëherë zbatohet përcaktimi i shkronjës B të këtij kreu.

V. Dispozita të fundit

1. Ngarkohet Drejtoria e Sigurisë Ushqimore, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, si dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT
RURAL DHE ADMINISTRIMIT
TË UJËRAVE
Edmond Panariti



SHTOJCA I
LISTA E PROCESVEVE PËR PËRGATITJEN E USHQIMEVE TRADICIONALE

Copëtim	Shtresë
Ngrohje, gatim, pjekje, skuqje (deri në 240°C në presion atmosferik) dhe presion gatimi (deri në 120°C)	Ftohje
Prerje	Distilim/rektifikim
Tharje	Emulsifikim
Avullim	Ekstraktim, duke përfshirë tretësit ekstraktues në përputhje me udhëzim nr. 6, datë 14.5.2014, “Për tretësit ekstraktues të përdorur në prodhimin e produkteve ushqimore dhe përbërësve ushqimor”
Fermentim	Filtrim
Bluarje	
Zbutje	Tretje
Proces mikrobiologjik	Përzierje
Lëkurë	Filtrim
Presim	Ftohje /ngrirje
Pjekje/tiganisje	Shtrydhje

SHTOJCA II
PRANIA E SUBSTANCAVE TË CAKTUARA

Pjesa A

Substancat të cilat nuk shtohen si të tilla në ushqime

Acid agarik
Aloin
Capsaicin
1,2-Benzopiron, kumarin
Hipericine
Beta-asarone
1-Alil-4-metolsibenzen, estragjol
Acid hidrociyanik
Menthofuran
4-Alil-1,2-dimetoksibenzen, metileugenol
Pulegone
Quassin
1-Alil-3,4-metilen dioksi benzen, safrol
Teucrin A
Thujon (alfa and beta)



Pjesa B

Nivelet maksimale të substancave të caktuara, natyrisht të pranishme në aromatizues dhe përbërësit ushqimor me veti aromatizuese, në disa ushqime të përbëra në të cilat janë shtuar aromatizuesit dhe/ose përbërës ushqimor me veti aromatizuese

Emri i substancës	Ushqime të përbëra në të cilat prania e substancës është e kufizuar	Niveli maksimal mg/kg
Beta-asarone	Pije alkoolike	1,0
1-Alil-4-metoksibenzen,	Produkte qumështi	50
Estragol (*)	Fruta, perime të përpunuara (duke përfshirë kërpudhat, rrënjët, zhardhokët dhe bishtajoret), arrat dhe farat	50
	Produkte peshku	50
	Pije joalkoolike	10
Acid hidrocianik	Nuga (lloj karamele ose çamçakëzi), marzipan (lloj paste me sheqer ose fruta e perime) ose zëvendësuesit e tyre ose produkte të ngjashme	50
	Fruta të konservuar në guri	5
	Pije alkoolike	35
Mentofuran	Mendërz/çamçakëz me mente që përmban ëmbëlsira, me përjashtim të ëmbëlsirave me mikrofreskues të frymëmarrjes	500
	Ëmbëlsira me mikrofreskues të frymëmarrjes	3000
	Çamçakëz	1 000
	Mendërz/çamçakëz me mente që përmban pije alkoolike	200
4-Alil-1,2-dimetoksi-benzen,	Produkte qumështi	20
Metileugenol (*)	Përgatitje mishi dhe produkte mishi, duke përfshirë shpendët dhe kafshët e gjahut	15
	Përgatitje peshku dhe produkte peshku	10
	Supa dhe salca	60
	Aroma gati për t'i ngrënë	20
	Pije joalkoolike	1
Pulegone	Mendërz/çamçakëz me mente që përmban ëmbëlsira, me përjashtim të ëmbëlsirave me mikrofreskues të frymëmarrjes	250
	Ëmbëlsira me mikrofreskues të frymëmarrjes	2000
	Çamçakëz	350
	Mendërz/çamçakëz me mente që përmban pije joalkoolike	20
	Mendërz/çamçakëz me mente që përmban pije alkoolike	100
Kuasin	Pije joalkoolike	0,5
	Lloje buke	1



	Pije alkoolike	1,5
1-Alil-3,4-metilen dioksi	Përgatitje mishi dhe produkte mishi, duke përfshirë shpendët dhe kafshët e gjahut	15
benzen, safrol (*)	Përgatitje peshku dhe produkte peshku	15
	Supa dhe salca	25
	Pije joalkoolike	1
Teucrin A	Pije alkoolike me shije të hidhure ose e hidhur	5
	Likerna me shije të hidhur	5
	Pije të tjera alkoolike	2
Thujon (alfa dhe beta)	Pijet alkoolike, me përjashtim të atyre të prodhuara nga speciet Artemisia	10
	Pijet alkoolike të prodhuara nga speciet Artemisia	35
	Pijet joalkoolike të prodhuara nga speciet Artemisia	0.5
Kumarin	Lloje buke tradicionale dhe/ose sezonale që përmbajnë një referencë për kanellë në etiketë	50
	Drithëra për mëngjes që përfshijnë muesli	50
	Breakfast cereals including muesli	20
	Buke fine tradicionale dhe/ose sezonale që përmbajnë një referencë për kanellë në etiketë	15
	Ëmbëlsira	5

(*) Nivelet maksimale nuk zbatohet kur një ushqim i përbërë nuk përmban aromatizues të shtuar dhe vetëm përbërësit ushqimor me veti aromatizuese të cilat janë shtuar janë bimë aromatizuese ose erëza të freskëta, të thata ose të ngrira.

SHTOJCA III

LISTA E MATERIALEVE BURIMORE PËR TË CILAT ZBATOHEN KUFIZIME PËR PËRDORIMIN E TYRE NË PRODHIMIN E AROMATIZUESVE DHE PËRBËRËSVE USHQIMOR ME VETI AROMATIZUESE

Pjesa A

Materialet burimore të cilat nuk do të përdoren për prodhimin e aromatizuesve dhe përbërësve ushqimor me veti aromatizuese

Materiali burimor

Emri latin	Emri përgjithshëm
Forma tetraploide e Acorus calamus L.	Forma tetraploide e Calamus



Pjesa B

Kushtet e përdorimit të aromatizuesve dhe përbërësve ushqimor me veti aromatizuese të prodhuara nga materiale të caktuara burimore

Materiali burimor		Kushtet e përdorimit
Emri latin	Emri i përgjithshëm	
Quassia amara L. Dhe Picrasma excelsa (Sw)	Kuasia	Flavourings dhe përbërësit e ushqimit me veti aromatizuese të prodhuara nga material burim i cili mund të përdoret vetëm për prodhimin e pijeve dhe bukëve të ndryshme
Laricifomes officinales (Vill.: Fr) Kotl. et Pouz Ose Fomes officinalis	Kërpudhë e bardhë agarike	Flavourings dhe përbërësit e ushqimit me veti aromatizuese të prodhuara nga material burim i cili mund të përdoret vetëm për prodhimin e pijeve alkoolike
Hypericum perforatum L.	Aromatizuesi St John	
Teucrium chamaedrys L.	Mur ku rritet dushku	

SHTOJCA IV

KUSHTET PËR PRODHIMIN E AROMATIZUESVE TË PËRFTUAR NGA PROCESHE TERMIKE DHE NIVELET MAKSIMALE PËR SUBSTANCA TË CAKTUARA NË PROCESIN E PËRFTIMIT TERMIK TË AROMATIZUESVE

Pjesa A

Kushtet për prodhimin

- Temperatura e produkteve gjatë përpunimit nuk duhet të tejkalojë 180°C.
- Kohëzgjatja e përpunimit termik nuk duhet të kalojë 15 minuta në 180°C me kohë përkatësisht më të gjatë në temperatura më të ulëta, d.m.th., një dyfishim të kohës së ngrohjes për çdo ulje të temperaturës nga 10°C, deri në një maksimum prej 12 orësh.
- pH gjatë përpunimit nuk duhet të tejkalojë vlerën e 8,0.

Pjesa B

Nivelet maksimale për disa substanca

Substanca	Nivelet maksimale µg/kg
2-amino-3,4,8-trimetilimidazol [4,5-f] kuinoksalin (4,8-DiMeIQx)	50
2-amino-1-metil-6-fenilimidazol [4,5-b]piridin (PhIP)	50



VENDIM

Nr. 156, datë 24.12.2015

**MBI LËNIEN NË FUQI TË
VENDIMEVE NR. 139, NR. 140, NR.
141, NR. 145, NR. 146, NR. 147, NR. 148,
DATË 26.12.2014, SI DHE TË VENDIMIT
NR. 27, DATË 16.2.2015, TË BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE-s PËR
PERIUdhËN 1 JANAR 2016 –
30 QERSHOR 2016**

Në mbështetje të neneve 10, pika 2; 16; 20, germa “c”; dhe 109, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 15, pika 1, dhe 3, të ligjit nr. 138/2013, “Për burimet e rinovueshme”, i ndryshuar, nenit 15 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.12.2015, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike, si dhe rekomandimet e MEI-t për shtyrjen e afatit të tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike të miratuara për vitin 2015,

konstatoi se:

- Hartimi i akteve nënligjore dhe rregullatore përkatëse në përputhje me ligjin nr. 43/2015, nuk ka përfunduar.

- Mbyllja e detyrimeve të ndërsjella midis tre operatorëve është ende në proces rakordimi dhe ende nuk ka përfunduar.

- Tri kompanitë publike nuk kanë paraqitur planet e investimeve për vitin 2016.

- Tri kompanitë publike nuk kanë paraqitur aplikimet për rishikimin e tarifave për vitin 2016.

- Konstatohet një situatë e përmirësuar e sektorit, e cila shërben si indikator i mjaftueshmërisë së tarifave të vitit 2015 për kryerjen e një aktiviteti normal nga tre operatorët.

- Ministria e Energjisë dhe Industrisë, si dhe tri kompanitë publike janë shprehur pro shtrirjes së efektit të tarifave dhe çmimeve aktuale të energjisë elektrike për 6-mujorin e parë të vitit 2016.

- Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1033, datë 16.12.2015, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 221, datë 24.12.2015, është miratuar “Metodologjia e përcaktimit të tarifave fikse të

energjisë që do t'i paguhen prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet”. Në këtë VKM, i cili i shtrin efektet e tij për vitin 2016, në nenin 2 të tij është parashikuar dhe se ERE ngarkohet me detyrimin për të saktësuar se cili do të jetë çmimi i shitjes së energjisë së prodhuar nga prodhuesit e vegjël të energjisë për periudhën e ndërmjetme deri në daljen e një çmimi që do të aplikohet për vitin 2016.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të lërë në fuqi, deri në datën 30 qershor 2016, tarifat dhe çmimet e miratuara përkatësisht me vendimet si më poshtë:

- Vendimin nr. 139, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për vitin 2015”.

- Vendimin nr. 140, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për vitin 2015”.

- Vendimin nr. 141, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës për shërbimet ndihmëse të KESH sh.a. për vitin 2015”.

- Vendimin nr. 145, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për vitin 2015”.

- Vendimin nr. 146, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2015 në nivelin e tensionit 35 kV”.

- Vendimin nr. 147, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës mesatare të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2015”.

- Vendimin nr. 148, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për vitin 2015”.

2. Fuqia juridike e vendimit nr. 27, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, datë 16.2.2015, “Mbi miratimin e tarifës fikse të energjisë për vitin 2015, që do t'i paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet, zgjatet deri në marrjen e vendimit të shfuqizimit të tij nga Bordi i ERE-s.

3. Pas publikimit të raportit vjetor (*Physical futures Annual report*) nga bursa e Hungarisë HUPX, për vitin përkatës, siç përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1033, datë



16.12.2015, ERE do të shprehet me vendim “Mbi miratimin e tarifës fikse të energjisë për vitin 2016, prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet”.

4. Përditësimi dhe kompensimi i të gjitha efekteve të mundshme financiare për të licencuarit do të bëhet brenda vitit 2016.

5. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë të interesuarit për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 157, datë 28.12.2015

**MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI
NË RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR
TË ENERJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 99; 109 dhe 110/2 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2015, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, në lidhje me një ndryshim në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar,

konstatoi se:

- ERE ka detyrimin e përshtatjes së kuadrit ligjor ekzistues me parashikimet e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Organi i administratës në ushtrimin e funksioneve të tij, e në zbatim të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative”, duhet të respektojë parimin e drejtësisë, barazisë dhe proporcionalitetit.

- Në nenin 99, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se “çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në kapitullin IX.1.3, germa “g”, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, me përmbajtjen si më poshtë:

“Duke filluar nga 1 janari 2016, çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike sipas legjislacionit në fuqi”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a. dhe OST sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 158, datë 28.12.2015

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ALBANIAN GENERAL ELECTRICITY”
SHA, NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT
TË ENERJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “ç”; 39, pika 3; dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “P”; 5, pika 1, germa “P”; 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa “a” e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albanian General Electricity” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Albanian General



Electricity” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin të shoqërisë “Albanian General Electricity” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmet

VENDIM

Nr. 159, datë 28.12.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “LE TRADING ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “ç”; 39, pika 3; dhe 110 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “f”; 5, pika 1, germa “f”; 13 dhe 14, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Le Trading Albania” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit,

Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Le Trading Albania” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/9, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Le Trading Albania” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmet

VENDIM

Nr. 160, datë 28.12.2015

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “GSA” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 57, DATË 22.6.2011

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d”; dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “g”; 13 dhe nenit 16 të rregullores “Për



procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k., për rinovimin e licencës në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “GSA” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4./10 germat “a”, “b”, “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “GSA” sh.p.k., në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.57, datë 22.6.2011, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmet

VENDIM

Nr. 161, datë 28.12.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “NISHOVA ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “NISHOVE”, ME FUQI TË INSTALUAR 1360 kW

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a”; 39, pika 4; dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Nishova Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC “Nishovë”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Nishova Energy” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pikat 1, 2 dhe 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Nishova Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Nishova”, me fuqi të instaluar 1360 kW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmet

VENDIM
Nr. 162, datë 28.12.2015

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “KISI – BIO - ENERGJI”
SHPK, PËR LËNIEN PENG TË
ASETEVE TË SAJ SI KOLATERAL
PRANË “RAIFFEISEN BANK”**

Në mbështetje të neneve 16, 44, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 6, 7 dhe 8, të rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 89, datë 13.12.2006, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikave 1.3 dhe 1.6, të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2015, pasi shqyrtoi kërkesën për lënie peng të aseteve të shoqërisë “Kisi – Bio - Energji” sh.p.k., si kolateral pranë “Raiffeisen Bank”, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Kisi – Bio - Energji” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7, pikat 1.1 dhe 1.2 (janë paraqitur në mënyrë korrekte).

- Neni 7, pika 1.3, geramat “b”, “e” (janë paraqitur në mënyrë korrekte).

- Neni 7, pikat 2, 3, 4 dhe 5 (ky informacion është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte).

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me: nenin 7, pika 1.3, geramat “a”, “c”, “d”, “f”, “g”, “h”, do të njoftohet subjekti, që në bazë të nenit 9 të Rregullores së Transferimit të Aseteve, t’i paraqesë ato brenda afatit të caktuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Kisi – Bio - Energji” sh.p.k., për lënie peng si kolateral të aseteve të shoqërisë pranë “Raiffeisen Bank”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmet

VENDIM
Nr. 163, datë 28.12.2015

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “HEC TERVOLI” SHPK,
PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË
SAJ SI KOLATERAL PRANË
“RAIFFEISEN BANK”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 44, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 6, 7 dhe 8, të rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 89, datë 13.12.2006, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikave 1.3 dhe 1.6 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2015, pasi shqyrtoi kërkesën për lënie peng të aseteve të shoqërisë “HEC Tervoli” sh.p.k., si kolateral nga pranë “Raiffeisen Bank”, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “HEC Tervoli” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7, pikat 1.1 dhe 1.2 (janë paraqitur në mënyrë korrekte).

- Neni 7, pika 1.3, geramat “b”, “e” (janë paraqitur në mënyrë korrekte).

- Neni 7, pika 2, 3, 4 dhe 5 (ky informacion



është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte).

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me: nenin 7, pika 1.3, germat “a”, “c”, “d”, “f”, “g”, “h”, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 9 të rregullores “Për procedurat e transferimit të asetëve nga të licencuarit”, t'i paraqesë ato brenda afatit të caktuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “HEC Tervoli” sh.p.k., për lënie peng si kolateral të asetëve të shoqërisë pranë “Raiffeisen Bank”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmet

VENDIM

Nr. 164, datë 28.12.2015

PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR. 143, DATË 26.11.2015, TË BORDIT TË ERE-s

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d”; 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 128 të Kodit të Procedurave Administrative, Bordi i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2015, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për ndryshimin e vendimit nr. 143, datë 26.11.2015, të Bordit të ERE-s,

konstatoi se:

- Shoqëria “C & S Energy” sh.p.k., është licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin nr. 143, datë 26.11.2015, të Bordit të ERE-s.

- Me vendimin nr. 143, datë 26.11.2015, është vendosur kushti që subjekti i licencuar të paraqesë në ERE menjëherë sapo të marrë

vërtetimin përfundimtar të likuidimit të tatim-taksave.

- Shoqëria “C & S Energy” sh.p.k., ka depozituar në ERE vërtetimin përfundimtar të likuidimit të tatim-taksave.

- Në pikën 2, të vendimin nr. 143, datë 26.11.2015, është parashikuar se me plotësimin e kushtit, ky vendim është subjekt rishikimi nga ERE.

- Neni 128 i Kodit të Procedurave Administrative i jep të drejtën organit të administratës, të ndryshojë/të zëvendësojë aktet administrative.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

Të ndryshojë pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 143, datë 26.11.2015, të Bordit të ERE-s, si më poshtë:

1. Të licencojë shoqërinë “C & S Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar.

2. Licenca e tregtimit të energjisë elektrike e shoqërisë “C & S Energy” sh.p.k., i shtrin efektet e saj duke filluar nga momenti i hyrjes në fuqi të vendimit nr. 143, datë 26.11.2015.

3. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmet

VENDIM

Nr. 165, datë 28.12.2015

PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR. 142, DATË 26.11.2015, TË BORDIT TË ERE-s

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d”; 110, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 128, të Kodit të Procedurave Administrative, Bordi i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2015, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për ndryshimin e vendimit nr. 142, datë 26.11.2015, të Bordit të ERE-s,



konstatoi se:

- Shoqëria “C & S Energy” sh.p.k., është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin nr. 142, datë 26.11.2015, të Bordit të ERE-s.

- Me vendimin nr. 142, datë 26.11.2015, është vendosur kushti që subjekti i licencuar të paraqesë në ERE menjëherë sapo të marrë vërtetimin përfundimtar të likuidimit të tatim-taksave.

- Shoqëria “C & S Energy” sh.p.k., ka depozituar në ERE vërtetimin përfundimtar të likuidimit të tatim-taksave.

- Në pikën 2, të vendimin nr. 142, datë 26.11.2015, është parashikuar se me plotësimin e kushtit, ky vendim është subjekt rishikimi nga ERE.

- Neni 128 i Kodit të Procedurave Administrative i jep të drejtën organit të administratës, të ndryshojë/të zëvendësojë aktet administrative.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

Të ndryshojë pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 142, datë 26.11.2015, të Bordit të ERE-s, si më poshtë:

1. Të licencojë shoqërinë “C & S Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar.

2. Licenca e prodhimit të energjisë elektrike e shoqërisë “C & S Energy” sh.p.k., i shtrin efektet e saj duke filluar nga momenti i hyrjes në fuqi të vendimit nr. 142, datë 26.11.2015.

3. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmet

VENDIM

Nr. 166, datë 28.12.2015

MBI KËRKESËN E KESH SHA PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË SHITBLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE MIDIS SHOQËRISË KESH SHA DHE SHOQËRISË “HEC LANABREGAS” SHA

Në mbështetje të neneve 16 dhe 22, germa “ë”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 3, pika 1, germa “rr”; dhe 14, të ligjit nr. 138/2013, “Për burimet e rinovueshme të energjisë”, pikës 4, të Modelit të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2015, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s dhe kërkesën e KESH sh.a., për miratimin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike midis shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë “HEC Lanabregas” sh.a.,

konstatoi se:

- Palët e kësaj kontrate KESH sh.a./FPSH dhe “HEC Lanabregas” sh.a., janë të licencuara për të ushtruar aktivitet në sektorin e energjisë elektrike nga ERE me vendimet respektive.

- Marrëdhënia ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë (“HEC Lanabregas” sh.a.) është një marrëdhënie e rregulluar nga ERE.

- Modeli i Tregut vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë kategori kontrate (miratuar me vendimin nr. 80, datë 23.10.2009, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s).

- Është në autoritetin e ERE-s përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve respektive ndërmjet pjesëmarrësve të tregut, si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre.

- Me miratimin e kontratës TIP, KESH sh.a. dhe prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike, që operojnë në treg, gjenden përpara detyrimit të respektimit të kushteve të parashikuara në kontratë.

- “HEC Lanabregas” ka një kapacitet të instaluar më të vogël se 15 MW, është i lidhur në shpërndarje dhe në bazë të ligjit nr. 138/2013, “Për burimet e rinovueshme të energjisë”, ai



kategorizohet si prodhues me përparësi, që prodhon energji elektrike nga burimet e rinovueshme.

- Energjia që prodhohet nga ky burim gjenerimi i rinovueshëm (“HEC Lanabregas”), duhet të blihet nga furnizuesi publik me shumicë, në bazë të çmimeve të rregulluara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi

VENDOSI:

1. Marrëdhënia e shitblerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga “HEC Lanabregas” për KESH sh.a., për vitin 2015 e në vijim, rregullohet nga kontrata tip e miratuar me vendimin nr. 80, datë 23.10.2009, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a./ FPSH dhe prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike, të ndryshuar”, dhe i shtrin efektet juridike që nga 1.1.2015 e deri në përfundimin e afatit të kontratës TIP, siç parashikohet në nenin 15 të saj.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrotjtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmet

KËRKESË

Nr. 6720, datë 23.12.2015 PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit “Pikë panoramike dhe sportive, Llogara, Himarë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Himarë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është 2,515,333 (dy milionë e pesëqind e pesëmbëdhjetëmijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë.

**ZËVENDËSMINISTËR I MINISTRISË SË
ZHVILLIMIT URBAN**
Alfred Dalipi

TABELA E PRONAREVE TE SHPRONESIMIT PER INTERES PUBLIK TE PROJEKTIT "PIKE PANORAMIKE DHE SPORTIVE, LLOGARA, HIMARE"

Nr	Lista e Pronareve	Lloji i pasurise	Nr. Hipotekore/P asurie	Zone Kadastrale	Sip. E Tokes qe Shpronosohet (m ²)	Vlera e tokes per Shpronesimet ne Leke	Vlera totale per shpronesimet = vlera e tokes	Vendodhje
1	Sipas Listes e bashkangjitur	Toke Kullote	376	2863	10.936,23	230,00	2.515.332,90	Llogara, Himare

SHUMA = 2.515.332,90



LISTA E BASHKËPRONARËVE

1-PASKAL	BABE	B.1/40
2-ILIA	BABE	B.1/40
3-FOTO	BABE	B.1/40
4-ARETI	GJINI	B.1/40
5-LLUKA	BABE	B.1/40
6-ŞOTIRAQ	KOKURI	B.1/64
7-FOTO	KOKURI	B.1/64
8-PETRO	KOKURI	B.1/64
9-KALIPSO	KOKURI	B.1/64
10-ARGJIRO	KOKURI	B.1/64
11-ANTONETA	TOSKA	B.1/64
12-XHULJETA	HAXHISI	B.1/64
13-POLIKSENI	SULAJ	B.1/64
14-PANDELI	PANO	B.1/8
15-NIKO	PANO	B.1/8
16-SOFIE	FURXHI	B.1/16
17-MARIE	THODHORIANI	B.1/16
18-THOMA	MEHILLI	B.1/64
19-KASIANI	MEHILLI	B.1/64
20-FROSINA	BOCI	B.1/64
21-MARGARITA	MEHILLI	B.1/64
22-VASIL	NESTURI	B.1/80
23-ANDON	NESTURI	B.1/80
24-KOZMA	NESTURI	B.1/80
25-PASKAL	NESTURI	B.1/80
26-ROLAND	NESTURI	B.1/80
27-ANGJELIQJ	MARGARITI	B.1/4

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 168 lekë